



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“SHITESË SHËRBIMESH ME FUNKSION AGROTURIZËM DHE HOTELERI NË
OBJEKTIN EKZISTUES “TAVERNA MELKO”, 1 DHE 2 KAT, ME VENDNDODHJE NË
FSHATIN BOBOSHTICË, BASHKIA KORÇË”

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Alketa Melko dhe Olsi Melko, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Shtesë shërbimesh me funksion agroturizëm dhe hoteleri në objektin ekzistues “Taverna Melko”, 1 dhe 2 kat, me vendndodhje në fshatin Boboshticë, Bashkia Korçë”, me zhvillues Alketa Melko dhe Olsi Melko.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Korçë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

BLEDI ÇUÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTORI AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

